

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E HËNË 6 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot do të doja të paraqisja shkurtimisht disa problematika, që na janë paraqitur nga zyra rajonale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe nga disa qendra të reja, për shkak të rëndësisë dhe impaktit social për ata qytetarë, të cilët nuk i plotësojnë kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe që trajtohen me pension social. Ajo që kërkohet dhe propozohet nga këto organizma është ndryshimi i nenit 5/1 të ligjit nr. 7703, datë 11 maj 1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, me qëllim uljen e moshës së përfitimit të pensionit social nga 70 vjeç në 65 vjeç për meshkujt dhe në 60 vjeç për femrat, duke qenë se në kushtet aktuale qytetarët e grupmoshës 60-69 vjeç, që nuk përfitojnë pension pleqërie për shkak të mungesës së viteve të punës, pra minimalisht 15 vjet vjetërsi pune me pagë minimale, hasin shumë vështirësi për sigurimin e të ardhurave të nevojshme për sigurimin e kushteve dinjitoze të jetesës.

Ndërkohë, kjo grupmoshë është e paaftë të sigurojë një vend pune për të garantuar nevojat bazike, të paktën individuale, sepse pjesa më e madhe e kategorive në fjalë vuajnë nga sëmundje kronike për shkak të kequshqyerjes dhe mostrajtit me medikamentet përkatëse për shkak të pamundësisë financiare. Një problematikë tjetër e shprehur nga qytetarët gjatë takimeve që kemi kryer gjatë kësaj jave është çështja e njohjes së periudhës së kryerjes së studimeve në shkollën e lartë si periudhë sigurimi për efekt pensioni pleqërie për meshkujt, sepse njihet vetëm ushtria, ndërkohë që aktualisht shumë persona kryejnë studimet e larta dhe nuk e kryejnë ushtrinë. Pra, kërkohet ndryshimi i nenit 42 të vitit 2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Një propozim tjetër i paraqitur është ndryshimi i VKM-së nr. 666, datë 10 tetor 2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”. Në këtë VKM janë përfitues të gjithë fëmijët që kanë braktisur shkollën ose janë në risk braktisjeje, familjet e të cilëve kanë nivel të ulët social dhe ekonomik, që do të thotë se janë punëkërkues të papunë me ndihmë ekonomike, invalidë, persona me aftësi të kufizuara dhe kategori të tjera si këto. Shqetësimi i ngritur është se ka një grup fëmijësh që vijnë nga familje që i përmbushin këto kritere, por nuk janë përfitues nga kjo VKM, sepse nuk kanë braktisur shkollën ose në risk braktisjeje. Dashje pa dashje destinohet që kjo kategori fëmijësh të braktisë shkollën, sepse vetëm kështu mund të përfitojnë, ndërkohë që duhet nxitur frekuentimi i shkollës.

Këto raste janë dërguar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Disa ankesa janë marrë në shqyrtim dhe së shpejti do të zhvillojmë edhe një seancë dëgjimore, ku ftohen të jenë të pranishëm edhe shumë kolegë deputetë nga komisionet përkatëse. Një rast tjetër në Korçë, që ne si zyrë e Komunikimit me Zgjedhësit kemi marrë në shqyrtim, është për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një gjymtyrë. Rasti që po ndjek është një zonjë që ka vetëm një dorë. Deri para disa vitesh kjo zonjë ishte përfituese e kempit, por ka 2 vjet që i është ndërprerë. Zonja ka shkuar pranë zyrës së punës dhe është regjistruar si punëkërkuese e papunë. Edhe pse nuk i mungon dëshira për të punuar, kjo gjë nuk është e mundur në ndonjë biznes privat. Unë kam kontaktuar edhe me disa drejtues të këtij institucioni, të cilët janë të gatshëm për ta mbështetur, duke e futur në skemën e nxitjes së punësimit për personat me aftësi të kufizuara, por nuk mund të përfshihet, pasi zonja nuk e gëzon këtë status, edhe pse është e shqeshme që ajo është me aftësi të kufizuara.

Pra, kërkohet ndryshimi në ligj, në mënyrë që të shtohen edhe personat me një gjymtyrë, sepse, sipas legjislacionit në fuqi, ata quhen të aftë për punë dhe nuk mund të marrin vërtetim nga KMCAP-i që të trajtohen nga skema e nxitjes së punësimit. Kjo çështje kërkon, gjithashtu, edhe një rimendim nga ekspertët e skemave të PAK-ut. Për të gjitha çështjet që trajtova do t'i

drejtohem me shkrim ministrisë përgjegjëse për të bërë të mundur zgjidhjen e problemeve që përfshijnë një kategori të konsiderueshme qytetarësh. Faleminderit!